

PLATFORMA E TREGTIMIT UNION CHANGE

Regjistrimi per here te pare

Platforma e tregtimit Union Change është produkti më i ri i cili i shtohet gamës së madhe të produkteve që i shtohet klientëve të Union Bank. Platforma e tregtimit online Union Change është ndërtuar për t'i ardhur në ndihmë ZKV, Biznesit dhe Individëve për të tregëtuar monedhat për nevoja të tyre online fare lehtë. Kjo do të thotë që nëpërmjet kësaj platforme çdo klient kërkon ose ofron çmime për monedhat e tij dhe më pas bën konvertimin e monedhave nëpërmjet llogarive të bankave që ai ka pranë Union Bank në mënyrë automatike.

Hapi i parë i procesit të regjistrimit të klientit në platforme është paraqitja pranë një dege të Union Bank dhe plotesimit të formularit të aplikimit për regjistrim në uChange. Pjesa tjetër e procedurës kryhet nga banka.

Pasmbarimit me sukses të regjistrimit në platforme, në adresën emailit të klientit do të vijë një email me Subject: Reset password instructions. Ky email përmban një link i cili mundëson vendosjes së passwordit. Figura me poshte.

From: noreply@filosoft.it <noreply@filosoft.it>
Sent: Monday, December 23, 2024 11:44 AM
To: Albi Karapici <[albi.karapici@...al](mailto:albi.karapici@...)>
Subject: Reset password instructions


Ky email përmban linkun për të vendosur një password të ri


[Krijo password të ri](#)

Nëse ju nuk e kërkuat këtë, ju lutemi ta injoroni këtë mesazh.

Passwordi nuk do të ndryshohet deri në momentin që ju të klikoni linkun më sipër dhe të krijoni një password të ri.

Do të klikojmë mbi [Krijo password të ri](#) i cili ndodhet brenda emailit të ardhur. Pasi kemi klikuar mbi [Krijo password të ri](#) do të na shfaqet një dritare e re e, figura me poshte, cila do të na kerkoje të vendoset dhe të riperseritet passwordi. Fjalëkalimi duhet të ketë të paktën 10 karaktere, duke përfshirë të paktën 1 shkronjë të madhe, shkronja të vogla, numër dhe karakter të veçantë.



 **UNIONBANK**

**Mire se erdhet ne
Union Change**

Shkruani fjalëkalimin tuaj të ri

Enter Password

Confirm Password


KONFIRMO

Pasi kemi vendosur sakte passwordin ne te dy vendet respektive klikojme mbi butonin KONFIRMO. Do te shikojme mesazhin i cili na informon se passwordi eshte vendosur me sukses. Ne fund klikojme mbi butonin MBYLL per te perfunduar kete proces.




Aksesimi ne platforme

Per te aksesuar platformen Union Change do te klikoje mbi linkun <https://unionchange.unionbank.al> Ne dritaren qe na hapet do te vendosim adresen e e-mail dhe passwordin dhe me pas klikojme butonin LOG IN. Ne kete moment ne adresen tone te e-mail do te vije nje kod 6 shifror.



Kete kod e vendosim, brenda rreth 5 minutave, ne dritaren dhe me pas klikojme tek butoni VERIFIKO per te hyre ne platforme. Pasi kemi hyre ne platforme do te na shfaqet pamja si me poshte. Platforma Union Change perbehet nga Grafiket e monedhave dhe Platforma e Tregtimit e cila mundeson shitblerjen e monedhave.



PLATFORMA E TREGTIMIT ONLINE përbëhet nga katër nen-menu bazë si në foton më poshtë :

PLATFORMA E TREGTIMIT		
Portofoli	Shit Monedhë	Bli Monedhë
Balanca e Llogarisë		
Account Number	Balance	Limit
196-196763262010119	ALL 2,086,527.14	ALL 1,000,000.00
112-112763262060248	\$20,995.57	\$50,000.00
195-195763262010124	€24,200.00	€50,000.00


Në menunë Platforma e Tregtimit do të na shfaqen gjëndjet aktuale të llogarive për monedhat Lek, Eur dhe USD të cilat është rënë dakort me bankën për të këmbyer monedhat. Në figurën më sipër do të shikojmë edhe limitin e mbetur të tregtimit.


Këmbimet online të monedhave në UNION CHANGE


Urdhrat Fiks në PLATFORMEN UNION CHANGE

Nëse ne do të blejmë apo të shesim një monedhë në tregtimin online ka dy opsione. Opsioni i parë është të klikojmë ne një nga menutë Shit Monedhe apo Bli Monedhe të cilat gjenden në pamjen qendrore të Union Change. Sapo të klikojmë një nga opsionet Shit Monedhe apo Bli Monedhe do të na shfaqet një liste me sasi dhe çmimesh të ndryshme të ofertave. Këto janë oferta të cilat tregtohen online nga ZKV, Kompani, Banka apo Individ të ndryshëm. Në

shembullin më poshtë do të tregojmë hapat që duhen ndjekur për të blerë EUR.



Aktualisht kemi tre ofrues online me kurset dhe sasi të respektive që ata tregëtojnë në këtë moment. Oferta me kursin më të mirë do të shfaqet gjithmone e para. Kursi më i mirë do të pasqyrohet automatikisht edhe në grafik të asaj monedhe. Nëse do të kishim më shumë oferta me anë të filtrit që dodhet aty  mund të grupojmë ato që na duhen për punën tonë. Nëse duam të blejmë vetëm 500 eur nga ofruesi i parë mjafton të klikojmë tek opsioni BLEJ që ka ky ofrues dhe do të na shfaqet një dritare e re ku duhet të vendosim sasinë e eurove që ne duam të blejmë me kursin e afishuar. Ky ofrues ofron 1.000 eur me kurs 98.50 por ne do të blejmë vetëm 500 eur.



Ne duhet të vendosim vlerën 500 në dritaren ku platforma na pyet sa do të blesh me kursin e ofruar dhe llogarite ku do të kreditohen eurot që po blejme dhe llogarite në Lek për eurot që po blejme. Figura më poshtë.

PËRMBLEDHJE

Sa dëshironi të blini?

EUR: 500

€1.000.00 kërkuar

me një kurs këmbimi €1.00 = ALL 98.50

për shumën totale ALL 49,250.00

ANULO

Choose a bank account to receive

195-1952010124 - EUR

Choose a bank account to pay

Select


Select

196-1962010119 - ALL

Në fund klikojme KONFIRMO dhe kështu ne sapo kemi blerë 500 euro online. Nje dritare do te na tregojte qe perfunduam me sukses kete blerje si ne figuren me poshte.

TRANSAKSIONI U KRYE ME SUKSES

Ju falenderojmë për urdhërin tuaj!



Ne do të dërgojmë përditësime me email në lidhje me statusin e urdhërit tuaj. Ju gjithashtu mund të gjeni detajet e urdhërit tuaj në Platformën e Tregimit, nën skedarin Urdhërat.

MBYLL

Do të shikojmë që edhe gjendja e llogarive ne banke do të ndryshojë automatikisht ! Do te shtohet me 500 eur dhe pakesohet me 49.250 leke.


E njëjta rrugë do të ndiqet në rast se ne do të duam të shesim Eur por duhet të klikojmë në menunë Shit Monedhe për të gjetur ofruesin e eurove në platformë.

Urdhrat fleksibel në PLATFORMEN UNION CHANGE


Në shembullin më sipër ne treguam si mund të blejmë 500 eur në platformë nga nje klient i cili ofronte 1.000 eur. Në qoftë se një klient kërkon që të konvertojë një shumë tjetër të cilën nuk e përmbush direkt në menuntë Bli Monedhe apo Shit Monedhe platforma ofron dy mundësi. Mundësia e parë është që të pyesim platformën se me çfarë çmimi mund të blejmë apo te shesim një monedhë të caktuar. Mundësia e dytë është që ai ta vendosë vetë shumën dhe kursin sipas dëshirës së tij .

Në opsinin e parë kur pyesim platformën ne do të aplikojmë një Fleksibel URDHER. Nëse ne duam të pyesim platformën me çfarë çmimi mund të blejë psh 1.500 EUR ndjekim hapat e më poshtëm.


Si fillim klikojme mbi butonin BLINI që ndodhet në te djathte ne menunë qendrore të Platformës Online.



Në dritaren që shfaqet klikojmë mbi butonin URDHËR FLEKSIBEL.



Ne dritaren e re që shfaqet do të klikojmë monedhen që duam të tregtojmë, në rastin tonë do të blejmë. Klikojmë mbi monedhen EUR e cila ndodhet e afishur përmbri monedhave të tjera. Me pas zgjedhim llogarite që do kreditohen dhe debitojen. Poshtë pyetjes **Sa dëshironi të blini?** vendosim shumën që duam të blejmë. Vendosim shumën 1.500 që ne duam të blejmë dhe me pas BLEJ. Shiko figuren me poshtë.



Në këtë çast platforma kalkulon ofertat më të mira që kanë ofruar përdoruesit e platformës në këtë moment si në foton më poshtë.

OFERTA MË E MIRË

Totali është	Mesatarja e ponderuar është	Kurset aktuale të tregut janë
ALL 147,870.00 për €1,500.00	€1.00 = ALL 98.58 Kursi aktual i tregut është 98.50 ALL	€500.00 @ 98.50 €800.00 @ 98.60 €200.00 @ 98.70

Dëshironi të pranoni tërësisht apo pjesërisht këtë ofertë?

[ANULO](#) [PJESOR](#) [Të Gjitha](#)

Sistemi ka gjetur ofertat më të mira të cilat kalkuloohen me një kurs mesatar, 1Euro = 98.58(shembulli jonë).Kjo do të thotë që për të blerë 1.500 Eur me URDHER Fleksibel ne duhet të paguajmë 147.870 ALL .Në fund të dritares janë tre opsione ALL ,PJESORE dhe ANULO.

Nëse çmimi i ofruar nga bashkmi ofertave që platforma gjeti na pëlqen,atëhere klikojmë **Te Gjitha** për të përfunduar të gjithë procesin . Do të shikojmë që edhe gjendja e llogarive ne banke do tëndryshoje automatikisht! Nje e-mail informues do të vijë në adresën e klientit për detajet e këtij transaksioni si dhe mënyrën e pagesës me një veprim të vetëm me gjithëse ne ja kemi blerë tre ofruesëve të ndryshëm.Këtë blerje ne mund ta shikojmë edhe tek menuja URDHRAT që ndodhet në Platformën e Tregëtimit Online.

Opsioni i dytë na jep mundësinë të blejmë një pjesë të këtyre ofertave.Nëse klikojmë PJESOR do kemi mundësinë që te zgjedhim ofertat që ne dëshirojmë si në figurën më poshtë.

PRANUAR PJESËRISHT

Totali është: **ALL 147,870.00 për €1,500.00**

Zgjidhni ofertat që dëshironi të pranoni:

Ofertë Online 1 €500.00 @ 98.5	Ofertë Online 2 €800.00 @ 98.6	Ofertë Online 3 €200.00 @ 98.7
-----------------------------------	-----------------------------------	-----------------------------------

[ANULO](#) [TJETRA](#)

Pasi klikojmë ofertat që duam,klikojmë në TJETRA për të kaluar në hapin tjetër.

PRANUAR PJESËRISHT

Totali është: **ALL 147,870.00 për €1,500.00**

Zgjidhni ofertat që dëshironi të pranoni:

Ofertë Online 1 €500.00 @ 98.5	Ofertë Online 2 €800.00 @ 98.6	Ofertë Online 3 €200.00 @ 98.7
-----------------------------------	-----------------------------------	-----------------------------------

[ANULO](#) [TJETRA](#)

Një dritare përmbledhëse do të na shfaqet me ofertat e selektuara së fundmi në të cilën dallojmë kursin mesatar,kundravleftën për ofertat që zgjedhëm. KLienti zgjedh vetem dy ofertat e para

me kursin me te mire me nje total blerje 1.300 eur me kurs mesatar 98.5615 leke

OFERTA MË E MIRË

Totali është	Mesatarja e ponderuar është	Kurset aktuale të tregut janë
ALL 128,130.00 për €1,300.00	€1.00 = ALL 98.5615 Kursi aktual i tregut është 98.50 ALL	€500.00 @ 98.50 €800.00 @ 98.60

Ju lutemi konfirmoni dhe dërgoni urdhërin tuaj.

[ANULO](#) [KONFIRMO](#)

Klikojmë konfirmo e cila gjendet në fund të faqes për të përfunduar me sukses këtë operacion. Një dritare informuese do të na tregojë që ne sapo blemë 1.300 eur me kursin mesatar të ofertave që ne selektuam . Do të shikojmë që edhe gjendja e llogarive ne banke do të ndryshojë sipas blerjes tone ne menyre automatike. Një e-mail do të vijë në adresën tonë me detajet e këtij operacioni dhe do të na tregojë se si do të behet likujdimi nëpërmjet llogarive, gjithashtu të dhënat e ketij operacioni do të mund t'i gjejmë në menunë URDHER te menuse se tregëtimit online te monedhave.

TRANSAKSIONI U KRYE ME SUKSES

Ju falenderojmë për urdhërin tuaj!



JU të blera **€1,300.00** me një mesatar të ponderuar prej **€1.00 = ALL 98.5615** për shumën totale **ALL 128,130.00**
Ju gjithashtu mund të gjeni detajet e urdhërit tuaj në Platformën e Tregëtimit, nën skedarin Urdhërat.

Dëshironi të vendosni një Urdhër Fiks për vlerën e mbetur €200.00? [Kliko këtu!](#)


[MBYLL](#)

Në menunë Portofoli do të shikojmë që gjendja e llogarise tone ka ndryshuar .

Pjesa e mbetur prej 200 eur platforma na ofron një mundësi shtesë që ne mund ta vendim si kërkesë tonën me çmimin që duam ne me anë të URDHËRIT FIKS tek **Kliko Ketu** që tregohet në foton më sipër.

URDHER FIKS në PLATFORMEN UNION CHANGE

Opsioni URDHËR FIKS në menunë e Union Change na ofron një mundësi që ne mund të shesim apo të blejmë me çmimin që duam ne, jo si bashkim i disa ofertave. Për të vendosur një URDHËR FIKS është shumë thjeshtë. Nësë do kemi blerje klikojmë Blej , nëse do kemi shitje klikojmë në Shes si ne figuren me poshte



Ne dritaren e re qe hapet do te klikojme mbi monedhen qe do te tregetojme sepse butoni URDHËR Fiks eshte gjithmone I selektuar,zgjedhim llogarite ,vendosim shumën që do te tregtojmë poshte Sa dëshironi të Shisni ? dhe kursin që duam ne si në foto poshtë.

Mund të zgjedhim edhe opsionin totali , pra sa lek do të paguajmë për të blerë 3.000 eur dhe sistemi e llogarit kursin nëpërmjet shumës që do paguajme dhe shumës që do të blejmë.Në fund zgjedhim SHES sepse në rastin tonë po deshirojme te shesim.Në dritaren e re që do të na shfaqet do të shikojmë të gjitha detajet e ofertes tonë.Shuma që do të shesim , kursin që ne duam të shesim si dhe kundravleftën.Në fund klikojme KONFIRMO për në hapin tjetër.

Pasi klikojme KONFIRMO do te na shfaqet nje dritare e re e cila na informon qe oferta jone eshte postuar me sukses.



Kjo ofertë do të afishohet ne menunë Shit/Bli Monedhe të platformës së tregëtimit online dhe ne nuk mund ta shikojmë sepse nuk mund të blejmë apo të shesim ofertat tona.

Nëse do të klikojmë në Portofoli do të shikojmë që gjendja e llogarise do te zbrese me 3.000 EUR. Gjendja e llogarise ne leke do te ndryshoje ne momentin qe dikush do te bleje urdhrin tone. Një e-mail informues do të vijë në adresën tonë për vendosjen e urdhërit si dhe në momentin e shitjes së ofertës tonë.


Në shembullin e URDHËRit Fleksibël tek blerja pjesore , vlerën e mbetur mund ta tregëtojmë me një URDHËR FIKS po të klikojme tek **Kliko Ketu** që na shfaqet në fund të blerjes pjesore. Pasi kemi klikuar **Kliko Ketu** do të na shfaqet dritarja e mëposhtëme dhe ne duhet të vendosim vetëm kursin për pjesën e mbetur .Ne fund klikojme mbi butonin TJETRA.



Pasi kemi vendosur kursin qe ne deshirojme te vendosim urdherin tone ne platforme do te kemi pamjen e meposhteme.




Klikojme KONFIRMO dhe urdhri do te vendoset me sukses ne platforme.




Menuja URDHËR në Platformën Union Change

Të gjitha veprimet e kryera në Platformën e Union Change do të shfaqen në menunë URDHËR të platformes online. Aty nëpërmjet filtrimit të veprimeve mund të ndërtojmë raporte dhe më pas t'i shkarkojmë në një document format excel. Të parat që do të shfaqen në URDHËR do të jenë Urdhërat Aktive që nuk janë shitur dhe poshtë tyre veprimet e përfunduara.

Nëse ne kemi vendosur një URDHËR FIKS 10.000 eur dhe dikush blen vetëm 5.000 eur në menunë URDHËR urdheri jonë do të shfaqet **50%** i kryer si në figurën më poshtë.




Nëse do të klikojmë ofertën tone aktive do të shikojmë edhe detajet se sa % e ofertës tone është likjuar dhe sa ka mbetur pa likjuar si në fig më poshtë.




Pjesa e mbetur e ofertës do të rrijë aktive në menunë Bli/Shit Monedhe të klientëve të tjerë .


Nëse ne do të duam te fshijmë një urdher , nëse e kemi hedhur gabim apo është mbushur pjesërisht , duhet të shkojme tek URDHRAVE, të gjejmë urdhërin i cili është ende aktiv të klikojmë dhe më pas ANULO URDHËRIN



KURSET E TREGUT

Një pjesë të rëndësishme në Platformën Union Change kanë edhe grafiquet.Këto grafique na ofrojnë informacion të rëndësishëm sidomos përpara tregëtimit online të monedhave.Këto grafique na ofrojnë çmimet on line të monedhave bazë te tregëtuar **vetem** ne platforme.Me anë të grafiqueve ne shikojmë edhe trendin rritës apo zbritës të monedhave , qe na shërben shumë për tregëtuar me çmime sa më të mira.




Grafiqet mund t'i zmadhojmë për patur një pamje më të qartë duke klikuar në shenjën  që ndodhet pranë çdo grafiku.




Nëse duam që grafiku të jetë me frekuencë çdo orë, ditore, javore apo mujore klikojmë në një nga opsionet e afishuara mbi grafik .


Rregullimi i profilit të përdoruesit

Platforma Union Change I krijon mundesine qe nje perdorues te kete akses ne disa llogari apo kompani te ndryshme. Per te bere ndryshimin e aksesit nga llogaria individuale ne llogari kompanie na mundeson menuja e Rregullimit te Profilit te Perdoruesit. Në këtë menu do të bëjmë dhe ndryshimin e passwordit!


Në fillim klikojmë në butonin  i cili ndodhet lart në të djathtë në platformë si në figurën më poshtë :



Pasi kemi klikuar do të na shfaqet dritarja e më poshtëme :




Profili i përdoruesit është i ndare në dy menu. Në menunë e parë kemi një informacionin e përdoruesit dhe të ndryshimit të Passwordit. Nëse do të bëjme ndryshim të passwordit klikojme mbi butonin **“NDRYSHO FJALËKALIMIN”** dhe do të na shfaqet dritarja si në figurën më poshtë.



Në fillim vendosim passwordin që kemi aktualisht ndërsa më pas vendosim passwordin e ri të cilin e ri konfirmojmë në rreshtin konfirmo passëord. Në fund RUAJ për të ruajtur më sukses ndryshimet. Pasi kemi klikuar RUAJ një dritare e re na shfaqet dhe na njofton që password i ri është ndryshuar me sukses. Fjalëkalimi duhet të ketë të paktën 10 karaktere, duke përfshirë të paktën 1 shkronjë të madhe, shkronja të vogla, numër dhe karakter të veçantë.

Në menunë e dytë të rregullimeve të përdoruesit mundesohet kalimi i aksesit nga llogaria personale në llogarinë e kompanisë ky përdoruesi është i lidhur si në figurën më poshtë. Mjafton të klikojmë një nga rreshtat LLogari Private apo LLogari Biznese për të bërë dhe mundur aksesin për

secilen nga llogarite qe ne duam te tregetojme.



Pasi kemi klikuar nje nga opsionet do te na shfaqet pamja qendrore e platformes Union Change.